



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.57

2006

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr.9538 datë 22.5.2006	Për një shtesë në ligjin nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar..... 1627
Ligj nr.9539 datë 22.5.2006	Për disa ndryshime në ligjin nr.8498, datë 10.6.1999 “Për ratifikimin e “Konventës së Këshillit të Europës për ndihmë të ndërsjellë juridike në fushën penale” dhe të protokollit të saj shtesë”..... 1627
Ligj nr.9540 datë 22.5.2006	Për një ndryshim në ligjin nr.9314, datë 11.11.2004 “për privatizimin e aksioneve, pronë e shtetit shqiptar, të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë”..... 1628
Ligj nr.9541 datë 22.5.2006	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror””..... 1629
Ligj nr.9542 datë 22.5.2006	Për disa ndryshime në ligjin nr.8996, datë 30.1.2003 “Për njësitë e matjes dhe kontrollin e mjeteve matëse (Metrologjinë)”..... 1631
Vendim i GJK nr.15, datë 25.5.2006	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.96, datë 21.01.2004 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si antikushtetues..... 1632

L I G J
Nr.9538, datë 22.5.2006

**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.8560, DATË 22.12.1999 “PËR PROCEDURAT
TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në nenin 30, pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Organet tatimore, brenda pesë ditëve nga hedhja e të dhënave në regjistrin kombëtar të tatimpaguesve, duhet të dërgojnë në regjistrin tregtar një kopje të numrit të identifikimit si subjekt fiskal.”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4901, datë 2.6.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

L I G J
Nr.9539, datë 22.5.2006

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8498, DATË 10.6.1999 “PËR RATIFIKIMIN E
“KONVENTËS SË KËSHILLIT TË EUROPËS PËR NDIHMË TË NDËRSJELLË JURIDIKE
NË FUSHËN PENALE” DHE TË PROTOKOLLIT TË SAJ SHITESË”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në nenin 2 të ligjit nr.8498, datë 10.6.1999 “Për ratifikimin e “Konventës së Këshillit të Europës për ndihmë të ndërsjellë juridike në fushën penale” dhe të Protokollit të saj shtesë”, bëhen këto ndryshime:

1.Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Lidhur me nenin 16 paragrafi i dytë, kërkesa për ndihmë të ndërsjellë dhe dokumentet që u

bashkëlidhen shoqërohen me përkthimin autentik zyrtar në gjuhën shqipe dhe, kur nuk është e mundur, në gjuhën angleze.

Republika e Shqipërisë, për dokumente më të gjata, si dhe në rastin kur marrësi është shtetas shqiptar ose kur vendbanimi i tij/saj është në Shqipëri, rezervon të drejtën për të kërkuar një përkthim autentik zyrtar në gjuhën shqipe, e përcaktuar kjo rast pas rasti.”.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Autoritetet gjyqësore, në kuptim të nenit 24 të kësaj Konvente, janë Gjykata e Lartë, gjykatat e apelit, gjykatat e shkallës së parë, Prokuroria e Përgjithshme, prokuroritë pranë gjykatave të apelit dhe prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë.”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4902, datë 2.6.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

L I G J

Nr.9540, datë 22.5.2006

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.9314, DATË 11.11.2004 “PËR PRIVATIZIMIN E AKSIONEVE, PRONË E SHTETIT SHQIPTAR, TË BANKËS SË BASHKUAR TË SHQIPËRISË”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.9314, datë 11.11.2004 “Për privatizimin e aksioneve, pronë e shtetit shqiptar, të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë”, bëhet ky ndryshim:

Në nenin 4 pika 1 rreshti i dytë fjalët “brenda 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji” zëvendësohen me fjalët “brenda datës 31.12.2006.”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4903, datë 2.6.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

L I G J

Nr.9541, datë 22.5.2006

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8457, DATË 11.2.1999 “PËR INFORMACIONIN E KLASIFIKUAR “SEKRET SHTETËROR”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Pas nenit 1 shtohet neni 1/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 1/1
Fusha e veprimit

Ky ligj zbatohet për të gjitha institucionet shtetërore, qendrore ose të varësisë, për organet e drejtësisë, prokurorisë dhe/ose personat juridikë/fizikë, personat me imunitet, kur për ushtrimin e detyrave të tyre duhet të kenë akses në informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”.

Neni 2

Në nenin 2 “Përkufizime” bëhen shtesat si më poshtë:

“INFOSEC” është zbatimi i masave të sigurisë për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar gjatë përpunimit, arkivimit ose transmetimit në sistemet e komunikimit, sistemet e informacionit dhe sistemet e tjera elektronike nga cenimi aksidental ose i qëllimshëm i objektivave të sigurisë: konfidencialitetit, integritetit dhe disponibilitetit.

“Konfidencialiteti” është mbrojtja e informacionit nga akses i paautorizuar.

“Integriteti” është mbrojtja e informacionit nga modifikimi i paautorizuar.

“Disponibiliteti” është vënia e informacionit në dispozicion të përdoruesve të autorizuar, kur kërkohet.”.

Neni 3

Në nenin 3 bëhen këto ndryshime:

1. Në fjalinë e parë, fjalët “tre nivelet” zëvendësohen me fjalët “katër nivelet”.

2. Pas shkronjës “c” shtohet shkronja “ç” me këtë përmbajtje:

“ç) “i kufizuar”, kur ekspozimi i paautorizuar mund të dëmtojë veprimtarinë ose efektivitetin e institucioneve shtetërore në fushën e sigurisë kombëtare.”.

Neni 4

Në nenin 9 shkronja “a”, fjalët “tre nivelet” zëvendësohen me fjalët “katër nivelet”.

Neni 5

Në nenin 21, pas shkronjës “c” shtohet shkronja “ç” me këtë përmbajtje:

“ç) personi ka zotësi për të vepruar.”.

Neni 6

Neni 23 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 23

Siguria në rrjetet informatike dhe në pajisjet e komunikimit

Masat e sigurisë: sigurimi fizik, sigurimi i personelit, sigurimi i informacionit dhe INFOSEC zbatohen për të krijuar një mjedis të sigurt për funksionimin e sistemeve të komunikimit, të sistemeve të informacionit dhe sistemeve të tjera elektronike.

DSIK është Autoriteti Kombëtar i Akreditimit të Sigurisë.

Drejtoria e Shifrës është Autoriteti Kombëtar për Sigurimin e Komunikimeve dhe Autoriteti Kombëtar i Shpërndarjes.”.

Neni 7

Në nenin 24 bëhen këto ndryshime:

1. Paragrafi i dytë ndryshohet si më poshtë:

“Ministria/institucioni, para nënshkrimit të një marrëveshjeje ose protokollit teknik, që përfshin shkëmbimin e informacionit të klasifikuar, duhet të marrë më parë mendimin e DSIK-së.”.

2. Pas paragrafit të dytë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Para nënshkrimit të një marrëveshjeje ose protokollit teknik, që përfshin shkëmbimin e informacionit të klasifikuar, duhet të jetë lidhur më parë marrëveshja për sigurimin e informacionit të klasifikuar ndërmjet autoriteteve të sigurimit kombëtar të shteteve palë.”.

Neni 8

Neni 27 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 27

Sistemi i zyrave të regjistrimit

Sistemi i zyrave të regjistrimit të informacionit të klasifikuar të NATO-s përbëhet nga Zyra e Regjistrimit Qendror në DSIK, zyrat e nënregjistrimit të informacionit të klasifikuar të NATO-s dhe pikat e kontrollit, që krijohen në ministri dhe institucione shtetërore.

Ky sistem është përgjegjës për regjistrimin, shpërndarjen dhe administrimin e informacionit të klasifikuar, të shkëmbyer në kuadrin e bashkëpunimit me NATO-n.

Nëpërmjet sistemit të zyrave të regjistrimit qarkullon edhe informacioni i klasifikuar i shteteve ose i organizatave të tjera ndërkombëtare.

Ministritë dhe institucionet shtetërore mbrojnë informacionin e klasifikuar të NATO-s, shteteve të tjera dhe organizatave ndërkombëtare, sipas standardeve që sigurojnë shkallë mbrojtjeje të njëjtë me atë që kërkohet nga NATO-ja, shteti ose organizata ndërkombëtare.”.

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4904, datë 2.6.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

L I G J

Nr.9542, datë 22.5.2006

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8996, DATË 30.1.2003 “PËR NJËSITË E MATJES DHE KONTROLLIN E MJETEVE MATËSE (METROLOGJINË)”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8996, datë 30.1.2003 “Për njësitë e matjes dhe kontrollin e mjeteve matëse (metrologjinë)”, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Pika 2 e nenit 3 ndryshohet si më poshtë:

“2. Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës bën përcaktimin e njësive të matjes, të pavarura dhe të rrjedhura nga SI-ja, si dhe të shumëfishave dhe nënfishave dhjetorë të sistemit SI.”.

Neni 2

Në nenin 6 bëhen këto ndryshime:

Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe Kalibrimit është person juridik publik, i specializuar për njësitë e matjes dhe kontrollin e tyre, në varësi të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.”.

Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Drejtori i Përgjithshëm emërohet dhe shkarkohet nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.”.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4905, datë 2.6.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

VENDIM
Nr.15, datë 25.5.2006

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “

Kujtim Puto	Anëtar i	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar i	“	“
Petrit Plloçi	Anëtar i	“	“
Vjollca Meçaj	Anëtare e	“	“

me sekretare Arbenka Lalica, në datat 28.02.2006 dhe 27.03.2006, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen me nr.18 Akti që i përket:

KËRKUES: NURIE NEOTOLEMI (KOCULI), përfaqësuar nga avokat Fatmir Gjika, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

LUAN E ZIJA MALAJ, përfaqësuar nga avokat Vangjel Kosta, me prokurë.

KAstriot MALAJ

SHPËTIM, EVELINA E BUKURIE KACULI, në mungesë.

KOMISIONI I KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE, DEGA VLORË, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.96, datë 21.01.2004 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Kërkuesja, për shfuqizimin si antikushtetues të vendimit të lartpërmendur, ka parashtruar si shkak mosvënien në dijeni për rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë dhe datën e shqyrtimit të tij.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Vjollca Meçaj, përfaqësuesin e kërkueses që u shpreh për pranimin e kërkesës, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara që kërkuan rrëzimin e kërkesës dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Gjykata e Rrethit Vlorë, me vendimin nr.980, datë 21.04.1995, ka vendosur detyrimin e të paditurve të njohin bashkëpronarë paditësit mbi dy godina dykatëshe, me përbërje dhomash dhe kufij të përcaktuar saktë në atë vendim, si dhe rrëzimin e padisë përsa i përket ndërtesës së emërtuar “Vila nr.3”.

Vendimi, pasi ka marrë formë të prerë, është rishqyrtuar mbi bazën e kërkesës së të paditurve. Pas rishqyrtimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr.113, datë 29.01.2002, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr.980, datë 24.01.1995 të Gjykatës së Rrethit Vlorë. Gjykata e Apelit Vlorë e ka ndryshuar këtë vendim dhe e ka rrëzuar padinë si të pabazuar. Ndërsa Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.96, datë 08.01.2004, ka prishur vendimin e Gjykatës së Apelit Vlorë dhe ka lënë në fuqi vendimin nr.113, datë 29.01.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Kërkuesja Nurie Neotolemi (Koculi), duke iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, ka pretenduar vetëm antikushtetushmërinë e vendimit nr.96, datë 08.01.2004 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Ajo parashtron se antikushtetutshmëria qëndron në faktin se asaj nuk i është komunikuar rekursi i paraqitur në gjykatë nga pala paditëse, si dhe data e shqyrtimit të tij, duke i mohuar në këtë mënyrë të drejtën e pjesëmarrjes në një proces gjyqësor ku ishte palë. Ajo pretendon se, si pasojë, janë shkelur standardet kushtetuese që kanë të bëjnë me procesin e rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës.

Gjykata Kushtetuese vlerëson se parimi që lidhet me detyrimin e palës për të provuar pretendimet e ngritura gjatë një procesi gjyqësor civil (barra e provës)¹, e ndjek palën edhe përpara Gjykatës Kushtetuese, kur ajo parashtron pretendimet e saj lidhur me standardet kushtetuese të gjykimit të zhvilluar nga gjykatat e zakonshme.

¹ Neni 12 i Kodit të Procedurës Civile “Pala që pretendon një të drejtë, ka detyrim që, në përputhje me ligjin, të provojë faktet mbi të cilat bazon pretendimin e saj”.

Duke e vlerësuar kërkesën nga kjo pikëpamje, konstatohet se kërkesja Nurie Neotolemi (Koculi) nuk arriti ta provojë pretendimin e saj gjatë shqyrtimit të çështjes në seancën e zhvilluar në Gjykatën Kushtetuese, ndonëse ligjërisht e mbartëte këtë detyrim. Për pasojë, kjo Gjykatë nuk mundi të vërtetojë se kërkesja nuk kishte pasur dijeni për paraqitjen e rekursit nga pala tjetër kundërshtare, prandaj kërkesa duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MENDIMI I PAKICËS

Jam kundër mendimit të shumicës që ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkuës.

Kërkesja Nurie Neotolemi (Koculi) në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese dhe në seancë ka pretenduar se i është mohuar e drejta e mbrojtjes pranë Gjykatës së Lartë, nuk ka pasur dijeni për datën e shqyrtimit të çështjes, sepse nuk i është komunikuar rekursi i ushtruar nga subjektet e interesuara para Gjykatës së Lartë. Këtë pretendim e ka lidhur me faktin se nuk ka marrë kopjen e rekursit dhe as dijeni për të, prandaj nuk ka pasur mundësi për të ndjekur gjykimin e çështjes pranë Gjykatës së Lartë.

Rekursi është ushtruar nga pala që nuk ka fituar gjatë gjyimit dhe ka pasur interesa të kundërta me kërkuësen.

Sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, njoftimi i rekursit të bërë kundër vendimit të Gjykatës së shkallës së parë dhe të apelit është detyrim ligjor i gjykatës. Neni 472 i Kodit të Procedurës Civile, që e njeh rekursin si mjet ankimi, nënkupton detyrimin e gjykatës për të zbatuar urdhërimet e nenit 447 të saj, sipas të cilit, ankimi u njoftohet palëve sipas rregullave të parashikuara në nenet 130 e 130 të këtij Kodi. Këto të fundit, përcaktojnë rregullat rigoroze që e detyrojnë gjykatën për të përmbushur këtë detyrim ligjor duke ia dorëzuar një kopje të tij personit që përcaktohet si marrës ose duke e bërë atë në vendbanimin ose në vendqëndrimin e tij. Për çështjen në shqyrtim, gjykata nuk e ka përmbushur këtë detyrim ligjor që është i lidhur me një standard kushtetues, me të drejtën e mbrojtjes. Kjo shkelje e ligjit ka ndikuar në preken e të drejtave të palëve që s’kanë qenë të pranishëm, sepse nuk u është dhënë mundësia që të realizojnë këtë të drejtë.

Gjatë gjyimit të çështjes është provuar se kërkuës nuk i është komunikuar rekursi i paraqitur para Gjykatës së Lartë e, si rrjedhojë e kësaj, ajo nuk ka pasur dijeni për datën e gjyimit të çështjes e as nuk ka pasur mundësi të mbrohet. Veç kësaj, gjykimi i çështjes në atë gjykatë është zhvilluar në mungesë të kërkuës pa u verifikuar nëse kërkesja ka marrë kopjen e rekursit të paraqitur nga subjekti i interesuar.

Pavarësisht nga sa ka rezultuar, shumica ka rrëzuar kërkesën e saj duke arsyetuar se ajo nuk ka vërtetuar pretendimin e saj kryesor që lidhet me moskomunikimin e rekursit. Ky qëndrim mendoj se është i gabuar. Në rastin konkret, në aktet gjyqësore nuk ka pasur asnjë provë që të vërtetonte të kundërtën e asaj që ka pretenduar ajo. Sipas kërkesave të ligjit dhe praktikës gjyqësore, prova që vërteton nëse është komunikuar ankimi është njoftimi që bën gjykata, një kopje e të cilit bashkëngjitet në aktet gjyqësore. Ky akt mungon dhe veç kësaj me asnjë provë tjetër nuk është provuar e kundërta e këtij pretendimi.

Për këtë problem, Gjykata Kushtetuese ka krijuar një praktikë të konsoliduar, dhe ka pranuar se mosnjoftimi i rekursit dhe si rrjedhojë e tij, mospasja dijeni për gjykimin në Gjykatën e Lartë e mosrealizimi i mbrojtjes për këtë shkak, e bëjnë procesin gjyqësor të parregullt në aspektin kushtetues.

Arsyetimi i shumicës që rrëzon kërkesën e kërkueses duke iu referuar nenit 12 të Kodit të Procedurës Civile më duket i gabuar. Përmbajtja e kësaj dispozite ka të bëjë me barën e provës si një detyrim për palën që pretendon një të drejtë në lidhje me thelbin e kërkesës që kërkon gjatë gjykimit e si e tillë ajo nuk ka asnjë analogji me detyrimet ligjore që ka gjykata për të zhvilluar një proces të rregullt për të cilin duhet të përmbushë shumë detyrime ligjore.

Në këto rrethana, Gjykata Kushtetuese duhej të pranonte kërkesën dhe të shpallte si të papajtueshëm me Kushtetutën vendimin që është bërë objekt kontrolli.

ANËTAR
F. Abdiu

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 042 555 63; ose 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 18 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI**

1. PËR PROKURIMIN PUBLIK	1500
(2006).....	
2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005)	600
.....	
3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006)	1500
4. PËR TAKSAT DHE TATIMET...(+ suplement 2006).....	1500
1. TREGUESI KRONOLOGJIK I	1500
LEGJISLACIONIT.....	
2. TREGUESI TEMATIK I	2000
LEGJISLACIONIT.....	

Botime të reja

1. PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500
2. KODI	1000
DOGANOR.....	
3. KODI DETAR	1000
.....	

Hyri në shtyp më 6.6.2006
Doli nga shtypi më 9.6.2006

Tirazhi: 4000 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja "Ilar"
Tiranë, 2006

Çmimi 100 lekë